

AKT THEMELIMI
I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
“WEBNET 2024” Shpk

Në bazë të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe Ligjit Nr.9273 datë 03.07.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshur:
Sot, më datë 10.04.2024 ne themeluesit kemi krijuar, Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar “WEBNET 2024” Shpk, me Ortak të vetëm shtetasin, Z. Fatos Arif Mehmeti i datëlindjes 16.05.1964, lindur në Durrës dhe banues në Rruga "Neki Libohova", Nd. P.617; H. Shk.2 Ap. Ap.4; Durres, 2004, shtetas shqiptar i identifikuar me ID G40516047F e cila do të funksionojë në bazë të këtij, AKT-THEMELIMI.

LLOJI DHE EMRI SHOQËRISË

NENI 1

Lloji i Shoqërisë Tregtare është Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar dhe emri i saj është “WEBNET 2024” Shpk.

SELIA E SHOQËRISË

NENI 2

Zyra Qëndrore e Shoqërisë Tregtare “WEBNET 2024” Shpk, e ka vendodhjen e saj në, Lagjja nr. 1, Rruga Shetitorja Bregdet, zona kadastrale 8512, Nr. Pasurie 24/190-N2

REGJIMI JURIDIK

NENI 3

Shoqëria është shqiptare me përgjegjësi të kufizuar.
Shoqëria fiton personalitetin juridik në momentin që ajo regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

NENI 4

Objekt i Shoqërisë Tregtare “WEBNET 2024” Shpk është:

Shërbime në fushën e azhornimit të të dhënave kompjuterike në faqe Interneti.

Fatos Mehmeti
Pa

KOHËZGJATJA

NENI 5

Shoqëria Tregtare "WEBNET 2024" Shpk, do të kryej veprimtarinë dhe aktivitetin e saj për një periudhe kohore të papërcaktuar.

Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

KAPITALI I SHOQËRISË

NENI 6

Kapitali Themeltar i regjistruar i Shoqërisë Tregtare "Edi Trans" Shpk, përbëhet prej 100,000.00 (njërqindë mijë) lekë.

Pjesmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e vetëm të:

1. Otaku i Vetëm Themelues Z. Fatos Arif Mehmeti: Zotëruese 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabartë me 100,000.00 (njërqindë mijë) lekë.

ADMINISTRIMI

NENI 7

Administrator i Shoqërisë i emëruar nga Asambleja e Ortakëve është Z. Fatos Arif Mehmeti me një afat 5 vjet me të drejtë rizgjedhje.

TË DREJTAT E SHOQËRISË

NENI 8

Shoqëria ka të drejtë të lidh kontrata dhe të nënshkruaj marrëveshje Brenda dhe jashtë vendit.

Shoqëria përgjigjet ndaj të treteve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e derdhur.

Shoqëria përballon humbjet vetëm dhe deri në kufirin e vlerës së kontributit të Kapitalit Themeltar.

VITI FINANCIAR-EKSPERTËT

NENI 9

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon me 31 Dhjetor.

Fatos Mehmeti

SHPËRNDARJA E FITIMIT

NENI 10

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën sipas ligjit dhe nga ana tjetër janë zbritur ose janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

Ky fitim shpërndahet midis Ortakëve të Shoqërisë sipas kontributit të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë.

LIKUJDIMI

NENI 11

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilën parashikojnë mënyrën e likujdimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likujdatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likujdatorit dhe emërtesën shtesë “shoqëri në likujdim e sipër”.

Likujdimi kryhet nga likujduesit e emëruar nga Ortakët.

Aktin e themelimit e lexuam dhe e gjetëm konform vullnetit tonë dhe e nënshkruajmë pa verejtje.

***ORTAKU I VETËM
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“WEBNET 2024” Shpk***

Fatos Arif Mehmeti

